




REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
KËSHILLI I UR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS			
ISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA			
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO			
Planuar / Dorezuar Planned / Delivered	21.05.2021	viti year	2021
Primi / Prodator Receiver / Delivery			
Organ / Njësia Org./Unit	Nr Prot Pr. No	Shtojca Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIPMBHUK	2578/2021		11.9.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.342/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga; Arben Mehmeti kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi, dhe Eshref Shabani, anëtar, si dhe Ilire Mehmeti Shaqiri, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, sipas Aktgjykimit A.nr.1754/2020 të datës 28.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.206/2020 të datës 28.07.2020 të parashtruar nga ankuesja kundër Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit në çështjen juridike "Paralajmërim Verbal" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1, nënparagrafi 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 21.05.2021, mori këtë.

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.206/2020 e datës 28.07.2020, e parashtruar nga ankuesja e shqyrtuar sipas Aktgjykimit A.nr.1754/2020 të datës 28.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

A r s y e t i m

Drejtoresha e Departamentit Ligjor, në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, përmes e-mailit me datë 16.06.2020, ankueses i ka shqiptuar masën disiplinore të paralajmërimit verbal.

Ankuesja e pa kënaqur me shqiptimin e masës disiplinore të paralajmërimit verbal, të datës 16.06.2020, të shqiptuar nga Drejtoresha e Departamentit Ligjor në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit me datë 14.07.2020, ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 3308/2020, në Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Ankuesja ende pa marr vendimin nga Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave, me datë 28.07.2020, ka parashtruar ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër masës disiplinore të paralajmërimit verbal të datës 16.06.2020 të cilin i ka shqiptuar Drejtoresha e Departamentit Ligjor në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit përmes emailit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 04.08.2020, ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit.

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit më datë 14.08.2020 ka përcjell përgjigjen në ankesë në këshill me dokumentacionin e kërkuar.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri në tetor 2020, ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, Ndërsa më datë 08.10.2020 janë zgjedhë 5 anëtar të këshillit dhe më datë 14/10/2021 janë themeluar edhe kolegjet profesionale nga ana e këshillit me që rastë është funksionalizuar këshilli.

Më datë 21.09.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesen për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesja e pakënaqur me njoftimin e datës 21.09.2019, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka hapur konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative, me datë 28.04.2021, me numër A.nr. 1754/2019, ka nxjerr Aktgjykim me të cilin ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit, duke e anuluar njoftimin e datës 14.09.2019, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke e detyruar këshillin që të vendos lidhur me ankesën e ankueses

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Ankesën e datës 28.07.2020 të parashtruar nga ankuesja me numër të protokollit 1436/2020, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Ankesën e datës 14.07.2020 me numër të protokollit 3008/2020 të parashtruar nga ankuesja në Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit; E-maili i datës 23.07.2020; E-maili i datës 20.07.2020; E-maili i datës 17.07.2020; E-maili i datës 16.06.2020; E-maili i datës 15.06.2020; Kërkesa për pushim e ankueses Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 04/08/2020 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës drejtuar Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit; Ndërsa më poshtë janë provat që janë objekt të administrimit dorëzuar nga organi i punësimit; Përgjigja në kërkesë e datës 14.08.2020 me numër të protokollit 1556/2020; Ndërsa po ashtu nga organi i punësimit janë dorëzuar edhe Ankesa e datës 28.07.2020, E-maili i datës 23.07.2020, E-maili i datës 17.07.2020,



Ankesa e datës 14.07.2020, E-maili i datës 15.06.2015, Kërkesën për pushim, E-maili i datës 16.06.2020, Njoftimi i datës 21.09.2020, por te cilat janë sjell edhe nga ankuesja dhe nuk u specifikuan me tepër, nga se janë administruar më larte; Akt Emërimi i datës 13.05.2015 i ankueses E-maili i datës 19.02.2021 i ankueses drejtuar Këshillit lidhur me njoftimin për hapjen e konfliktit administrativ.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankueses është e palejuar, *sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave fillimisht ka analizuar Aktgjykimin, me numër A.nr.1754/2019, të datës 28.04.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative, me të cilin Aktgjykim ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit, duke e anuluar njoftimin e datës 14.09.2019, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe duke e detyruar Këshillin të vendos lidhur me aneksen e ankuesit të datës 28.07.2019, të ankueses

Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se ndaj ankueses mbikëqyrësi i drejtpërdrejt, përmes emailit me datë 16.06.2020, i ka shqiptuar masën disiplinore paralajmërim verbal, ndërsa ankuesja kundër paralajmërimit verbal të datës 16.06.2020, me datë 14.07.2020, ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 3308/2020 në Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave, të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit, edhe përkundër faktit se nuk ka marr vendim nga Komisioni Për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave, me datë 28.07.2020 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës ende pa vendosë Komisioni Për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave në lidhje me këtë edhe pse ende nuk kishte kaluar afati ligjor i vendimmarrjes nga ky komision, e që sipas konstatimit të kolegjit ky veprim përmes kësaj ankesë në këshill është në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPPA-së.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se ankuesja ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ankesën e ka parashtruar jashtë afatit ligjor prej tridhjetë (30) ditësh të përcaktuar me dispozitat e nenit 127, paragrafi 1. të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: *Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ*, në kundërshtim me nenin 9, paragrafi 7, të Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, i cili përcakton se; **Komisioni duhet të merr vendim brenda afatit tridhjetë (30) ditësh nga data e pranimit të ankesës**, si dhe në kundërshtim me neni 11 të Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, i cili përcakton se: *"Kundër vendimit të Komisionit, palët e pakënaqura kanë të drejtë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, brenda afatit prej 30 ditësh"*. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se nga shkresat e lendes del se ankuesja ankesën e ka parashtruar me datën 28.07.2020, me numër protokollit 1436/2020, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër masës disiplinore- paralajmërimit verbal të datës 16.06.2020, të Drejtoreshës së Departamentit Ligjor në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit ende pa marr vendimin e Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit.



Poashtu me rastin e vendosjes në lidhje me këtë ankesë sipas aktgjykimit A.nr.1754/2020 të datës 28/04/2021, kolegji ka vërejt se mund të jetë bërë lëshim teknik në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, sepse nuk bëhet fjalë për anulim të aktit administrativë(njoftimit) të datës 14/09/2020, apo se ankuesja përmes padisë për konflikt administrativë ka gabuar apo ka bërë ndonjë lëshim teknik sa i përket datës së njoftimit të KPMSHCK-së, sepse sipas shkresave të lëndës bëhet fjalë për anulim të aktit administrativë(njoftimit) të datës 21/09/2020 me nr.Prot.1832/2020, të KPMSHCK-së, të cilin dokument e ka marrë pala dhe të cilin e ka atakuar përmes padisë në gjykatë.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda, A.nr. 342/2021, datë 21/05/2021

Ilire Mehmeti Shaqiri

Zyrtarë e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit
- Arkivitet të KPMSHCK-së,

